


Shkaqet e Vdekjeve, 2023

Tiranë, më 8 Korrik 2024: Numri i vdekjeve të regjistruara në Shqipëri gjatë vitit 2023, është 21.286, duke shënuar 11,3 % vdekje më pak, krahasuar me vitin e kaluar. Referuar shkakut kryesor të vdekjeve, 96,6 % e vdekjeve kanë ndodhur si pasojë e shkaqeve natyrale.

Fig.1 Vdekjet sipas shkakut kryesor, 2023 (në %)



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, INSTAT

Vdekjet nga grupsëmundja “Sëmundje të aparatit të qarkullimit të gjakut” zënë peshën më të madhe në totalin e vdekjeve të regjistruara me 51,7 %, duke vazhduar të jetë shkakut kryesor i vdekjeve. Krahasuar me vitin paraardhës, vdekjet nga kjo grupsëmundje kanë shënuar rënie me 15,9 %. “Sëmundjet kronike të zemrës” (37,4 %), “Sëmundjet ishemike të zemrës” (24,4 %) dhe “Sëmundjet e enëve të trurit” (24,2 %) zënë peshën më të madhe të vdekjeve në grupsëmundjen “Sëmundje të aparatit të qarkullimit të gjakut”.

Grupsëmundja “Simptoma, shenja dhe sëmundje të papërcaktuara mirë”, përbën grupin e dytë me peshën më të lartë të vdekjeve (20,9 %). Krahasuar me vitin e kaluar, janë shënuar 8,6 % më pak humbje jete. Vdekje nga pleqëria përbën 73,7 % të vdekjeve për këtë grupsëmundje.

Grupsëmundja “Tumoret” përbën grupin e tretë të sëmundjeve me peshën më të madhe të vdekjeve të regjistruara, 15,7 % të vdekjeve gjithsej. Krahasuar me vitin 2022, janë regjistruar 3,2 % më shumë humbje jete. Sëmundjet “Tumor malinj i aparatit të tretjes” (38,0 %), “Tumor malinj i aparatit të frymëmarrjes” (22,2 %) dhe “Tumor malinj i organeve urogenitale” (13,8 %) përbëjnë peshën më të madhe të vdekjeve në këtë grupsëmundje.

Krahasuar me vitin 2022, vdekjet nga grupsëmundja “Sëmundje të aparatit të frymëmarrjes” zënë peshën kryesore në rënien gjithsej të vdekjeve të regjistruara gjatë vitit 2023.

Tab.1 Shkaqet kryesore të vdekjeve sipas grupsëmundjes, 2022- 2023

Grupsëmundjet	2022	2023
Sëmundje të aparatit të qarkullimit të gjakut	13.082	11.002
Simptoma, shenja dhe sëmundje të papërcaktuara mirë	4.868	4.449
Tumoret	3.233	3.336
Dëmtime traumatike dhe helmime	813	792
Sëmundje të aparatit të frymëmarrjes	718	446
Sëmundje të sistemit nervor qëndror dhe organeve të shqisave	270	299
Sëmundje të aparatit të tretjes	258	249
Sëmundje të organeve urogenitale	234	249
Sëmundjet endokrinë të ushqyerit	221	217
Sëmundje mendore	127	104
Sëmundje që shfaqen në periudhën rreth lindjes	86	71
Sëmundje infektive e parazitare	25	32
Anomali të bashkëlindura	19	18
Sëmundjet të gjakut dhe të organeve formuese të gjakut	19	15
Ndërlikime të barrës, të lindjes dhe të periudhës së paslindjes	17	*
Sëmundje të sistemit të kockave dhe të muskujve	8	*
Sëmundje të lëkurës dhe indit qelizor nën lëkurë	0	*
Gjithsej	23.998	21.286


Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, INSTAT

*Vlera të fshehura për arsye konfidencialiteti

Vdekshmëria sipas gjinisë

Nga 21.286 të vdekur gjithsej, 53,8 % janë meshkuj dhe 46,2 % janë femra. Si te femrat dhe te meshkujt, grupsëmundja “Sëmundje të aparatit të qarkullimit të gjakut” përbën shkaku kryesor të humbjeve të jetës, përkatësisht 53,6 % femra dhe 50,0 % meshkuj. Grupsëmundja “Simptoma, shenja dhe sëmundje të papërcaktuara mirë” përbën shkaku e dytë kryesor të vdekjeve për të dyja gjinitë, ku përqindja e vdekjeve te femrat është më e lartë se te meshkujt, 24,3 % me 18,0 %. Grupsëmundja e tretë vijon me “Tumoret”, me përqindjen më të lartë të vdekjeve te meshkujt (18,0 %) krahasuar me femrat (12,9 %).

Fig.2 Grupsëmundjet kryesore të vdekjeve sipas gjinisë, 2023




Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, INSTAT

Vdekshmëria foshnjore

Në vitin 2023, janë regjistruar 144 vdekje foshnjore, 52,1 % janë neonatal i hershëm (0-6 ditësh), 18,0 % neonatal i vonshëm (7 -27 ditësh) dhe 29,9 % janë postneonatal (28-365 ditësh).

Norma e vdekshmërisë foshnjore është 6,1 për 1.000 lindje të gjalla, përkundrejt 6,5 në vitin 2022. Shkaqet kryesore të vdekshmërisë foshnjore janë “Sëmundjet që shfaqen në periudhën rreth lindjes” me 49,3 %, “Sëmundje të aparatit të qarkullimit të gjakut” me 20,1 % dhe “Anomali të bashkëlindura” me 9,7 % të vdekjeve të regjistruara.

Fig.3 Vdekshmëria foshnjore në kohë sipas grupsëmundjeve kryesore, 2023



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, INSTAT

Vdekshmëria sipas grup-moshës

Për grup-moshën 0-19 vjeç, pesha më e madhe e humbjeve të jetës lidhet me grupsëmundjet “Sëmundje që shfaqen në periudhën rreth lindjes” (29,5 %) dhe “Sëmundje të aparatit të qarkullimit të gjakut” (20,3 %).

“Dëmtime traumatike dhe helmime” (32,4 %) dhe “Sëmundje të aparatit të qarkullimit të gjakut” (27,0 %) përbëjnë grupet me peshën më të madhe në vdekjet e shkaktuara për grup-moshën 20-44 vjeç.

Për grupmoshat 45-64, 65-79 dhe 80+ vjeç, grupi kryesor mbetet “Sëmundje të aparatit të qarkullimit të gjakut”.


Tab.2 Vdekjet sipas grupsëmundjes dhe grup-moshës, 2023 (në %)

Grupsëmundjet	Grup-mosha				
	0-19	20-44	45-64	65-79	80+
Sëmundje infektive e parazitare	0,41	1,27	0,40	0,13	0,03
Tumore	5,39	16,58	32,34	22,91	5,99
Sëmundjet endokrinë të ushqyerit	0,00	0,18	0,98	1,29	0,91
Sëmundje të gjakut dhe të organeve formuese të gjakut	0,00	0,00	0,07	0,12	0,04
Sëmundje mendore	0,00	0,91	0,40	0,47	0,51
Sëmundje të sistemit nervor qëndror dhe organeve të shqisave	4,15	3,83	1,48	1,66	1,01
Sëmundje të aparatit të qarkullimit të gjakut	20,33	26,96	41,59	54,47	54,70
Sëmundje të aparatit të frymëmarjes	4,56	1,82	1,61	2,34	2,02
Sëmundje të aparatit të tretjes	0,42	2,00	3,20	1,41	0,39
Sëmundje të organeve urogenitale	0,42	0,55	1,21	1,64	0,88
Ndërlikime në barrë,të lindjes dhe të periudhës së paslindjes	1,66	0,18	0,00	0,00	0,01
Sëmundje të lëkurës dhe të indit qelizor në qelizë	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00
Sëmundje të sistemit të kockave dhe te kyçeve	0,00	0,00	0,00	0,00	0,01
Anomali të bashkëlindura	6,64	0,00	0,07	0,00	0,00
Sëmundje që shfaqen në periudhën rreth lindjes	29,46	0,00	0,00	0,00	0,00
Simptoma, shenja dhe sëmundje të papërcaktuara mirë	9,96	13,30	8,31	10,48	32,49
Dëmtime traumatike dhe helmime	16,60	32,42	8,34	3,08	1,01
Gjithsej	100	100	100	100	100

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, INSTAT

Analizuar sipas shkakut të vdekjeve, në grupsëmundjen “Tumoret”, përafërsisht gjysma e humbjeve të jetës i përket grup-moshës 65-79 vjeç (49,6 %). Në grupsëmundjen “Sëmundje të aparatit të qarkullimit të gjakut”, 51,3 % e humbjeve të jetës i përket grup-moshës mbi 80 vjeç. “Simptoma, shenja dhe sëmundje të papërcaktuara mirë” përbën shkakun kryesor të vdekjeve për grup-moshën mbi 80 vjeç (75,3%). Ndërkohë, në grupsëmundjen “Dëmtime traumatike dhe helmime”, 31,3 % e humbjeve të jetës i përket grup-moshës 45-64 vjeç.

Fig.4 Vdekjet sipas grupsëmundjeve kryesore dhe grup-moshës, 2023




Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, INSTAT

Vdekshmëria sipas qarqeve

Në vitin 2023, në secilin qark, numri më i madh i vdekjeve shkaktohet nga grupsëmundja “Sëmundje të aparatit të qarkullimit të gjakut” ndjekur nga “Simptoma, shenja dhe sëmundje të papërcaktuara mirë” dhe “Tumoret”.

Fig. 5 Vdekshmëria sipas grupsëmundjes dhe qarqeve, 2023 (në %)



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, INSTAT

Metodologjia

Të dhënat e shkaqeve të vdekjes

Të dhënat e vdekjeve sigurohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile sipas karakteristikave bazë demografike dhe shkakut të vdekjeve. Këto të dhëna bazohen mbi informacionin e marrë nga “skedat e vdekjeve” të plotësuara nga mjeku. Më pas, të dhënat pastrohen dhe përpunohen duke analizuar një sërë variablash si: përshkrimin me fjalë të sëmundjes, moshën dhe gjininë e personit, si dhe bëhet kodifikimi i shkakut sipas klasifikimit ndërkombëtar ICD -9.

Klasifikimi Ndërkombëtar "ICD-9" është klasifikimi ndërkombëtar i sëmundjeve, i cili bën grupimin në mënyrë të koduar të 17 grupeve kryesore të sëmundjeve. Kodimi për shkaqet e vdekjeve bëhet nga mjeku dhe përbën burimin më të plotë zyrtar statistikor të sëmundjeve që janë shkak i vdekjes.

Përkufizime

Shkaku i vdekjes është sëmundja ose simptoma që ka shkaktuar ose kontribuar në vdekje, si dhe rrethanat e aksidentit që kanë shkaktuar këto trauma (përkruhet në certifikatën e vdekjes).

Vdekja nënkupton zhdukjen e përhershme të të gjitha funksioneve vitale dhe pamundësinë e reanimimit në çdo kohë pas një lindjeje të gjallë. Ky përkufizim nuk përfshin vdekjen fetale.

Shkalla e vdekshmërisë foshnjore tregon raportin e numrit të vdekjeve për fëmijët nën moshën 1 vjeç gjatë vitit me numrin e lindjeve të gjalla të atij viti, i shprehur për 1.000 lindje të gjalla.

Vdekje aksidentale janë vdekjet të shkaktuara nga shkaqe të jashtme dhe përfshijnë aksidente të qarkullimit rrugor, aksidente të transportit ujor, aksidente hekurudhore, aksidente në punë, aksidente nga zjarri, rënie, rrëzime-aksidentale, aksidente nga veprues fizik të natyrshëm ose faktorë të mjedisit dhe aksidente të tjera.

Burimi i të dhënave: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.